



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve

Nr. 114/ Prot.

Tiranë, më 12/12.2019

171

RELACION

MBI

**LËNIEN NË FUQI TË VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-S, NR. 268, DATË
21.12.2018**

Të Nderuar Anëtarë të Bordit,

Në mbështetje të nenit 19, nenit 20 gërma c), nenit 83, nenit 85 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar; VKM-s nr. 244 datë 30.03.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar, Enti Rregullator i Energjisë është autoriteti përgjegjës për miratimin e tarifës së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe përcaktimin e çmimeve të rregulluara për klientët fundorë që furnizohen sipas shërbimit universal të furnizimit, sipas parashikimit të nenit 83, pika 1, të Ligjit nr. 43/2015, i ndryshuar.

ERE me vendimet nr. 182, datë 10.11.2017, dhe nr. 189, datë 23.11.2017 të Bordit të ERE-s ka miratuar “Metodologjinë e Llogaritjes së Tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” si dhe “Metodologjinë e Përcaktimit të Çmimeve për Shitjen e Energjisë Elektrike me Pakicë tek Klientët Fundorë që Furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)”.

Gjithashtu, referuar pikës 1 të nenit 21 të Rregullores për “Organizimin, Funkcionimin dhe Proçedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin nr. 96, datë 17.06.2016 të Bordit të ERE-s, i licencuari që kërkon përcaktimin e tarifave dhe çmimeve të shërbimeve të energjisë elektrike dhe të gazit natyror për vitin pasardhës jo më vonë se data 1 Shtator të vitit aktual duhet të paraqesë në ERE një kërkesë me shkrim, të shoqëruar me të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar sipas kësaj rregullore dhe metodologjive përkatëse.

Aplikimi i paraqitur duhet të shoqërohet me dokumentacionin përkatës sipas parashikimeve të nenit 22 të Rregullores për “Organizimin, Funkcionimin dhe Proçedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin nr. 96, datë 17.06.2016 të Bordit të ERE-s dhe “Sistemit të njehsuar dhe të standardizuar të llogarive për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike për aktivitetin e shpërndarjes dhe furnizuesit të shërbimit universal të energjisë elektrike”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 244, datë 26.11.2018.

Nisur nga sa më sipër, ERE me shkresën nr. 541, datë 10.09.2019, i është drejtuar shoqërisë OSHEE sh.a për paraqitjen e aplikimit për tarifën e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike si dhe çmimet me pakicë për klientët fundor që furnizohen nga FSHU për vitin 2020.

Deri më sot, shoqëria OSHEE sh.a. nuk ka paraqitur pranë ERE-s aplikim bazuar në detyrimet sipas legjislacionit në fuqi dhe kërkesës së lartpërmendur.

Në këto kushte, bazuar në nenin 20 gërma “c” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, ERE ka të drejtën të miratojë tarifa të përkohshme në rastet kur operatorët e transmetimit ose shpërndarjes krijojnë vonesa në ndryshimin e tarifave. Në rast se, tarifat e miratuara rezultojnë të ndryshme nga ato të përkohshme, ERE vendos masa të përshtatshme kompensuese.

Vendimi i Bordit të ERE-s me nr. 268, datë 21.12.2018 la në fuqi vendimin nr. 190, datë 30.08.2018 “Mbi shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë OSHEE sh.a. për tarifat e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike sipas nivelit të tensionit dhe lënien në fuqi të çmimeve me pakicë për klientët që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal për vitin 2018” me tarifat e shërbimit të shpërndarjes dhe çmimet e furnizimit me pakicë si vijon:

Tarifat e miratuara nga ERE për vitin 2019

TIPI I AKTIVITETEIT	TARIFAT E MIRATUARA	
Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV	1.5 Leke/Kwh	
Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 20 kV	3.9 Leke/Kwh	
Tarifa mesatare e shërbimit të shpërndarjes	4.79 Leke/Kwh	
Çmimi i shitjes për Klientët në 20 kV *	11 Leke/Kwh Në Pik 12.65 Leke/Kwh	
Çmimi i shitjes për Klientët në 10/6 kV *	11 Leke/Kwh Në Pik 12.65 Leke/Kwh	
* Miratim i përkohshëm për klientët që nuk arrijnë të sigurojnë furnizues në treg për shkak të pamundësisë objektive të operatorëve të sistemit në përputhje me VKM nr. 449, datë 15.06.2016, furnizimi si mundësi e fundit i këtyre klientëve kryhet në të njëjtat kushte me shërbimin universal të furnizimit me çmimet si më lart.		
Çmimi i shitjes për Konsumatorët e lidhur në TM dhe me matës në TU	12.4 Leke/Kwh Në Pik 14.3 Leke/Kwh	
Çmimet e shitjes me pakicë për klientët fundor	*Çmimet paraqiten në tabelen më poshte	
TARIFAT E SHËRBIMEVE TË SHITJES ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR KLIENTËT FUNDOR		
Niveli i tensionit	Çmimi (Leke/kWh)	Çmimi pik (Leke/kWh)
Furra buke dhe prodhim mielli në 10/6 kV	7.1	8.17
Klientë në 0.4 kV	14	16.1
Furra buke dhe prodhim mielli në 0.4 kV	7.6	8.74
Familjarë	9.5	
Tarifa për konsumin e energjisë elektrike në ambientet e përbashkëta (ndriçim shkalle, pompe, ashensor)	9.5	
Tarifë fikse e shërbimit për leximin "zero" (Leke/Muaj)	200	
*Çmimi i energjisë reaktive është sa 15% e çmimit të energjisë aktive		
*Orari pik gjatë të cilit do të aplikohet tarifa për energjinë e konsumuar në pik është		
Për periudhën 1 Nentor - 31 Mars nga ora 18:00 deri në 22:00		
Për periudhën 1 Prill - 31 Tetor nga ora 19:00 deri në 23:00		

Gjendur në kushtet kur:

- OSHEE sh.a. nuk ka paraqitur pranë ERE-s aplikim për tarifën e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike si dhe çmimet me pakicë për klientët fundor që furnizohen nga FSHU për vitin 2020, në zbatim të nenit 21 të “Rregullores për Organizimin, Funkionimin dhe Proçedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016.
- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 264, datë 20.12.2018, u miratua vendosja e periudhës tranzitore deri në fund të vitit 2019, për bërjen efektive të transferimit të licencave nga OSHEE sh.a tek OSSH sh.a dhe FSHU sh.a. Ky proçes ende nuk është përfunduar pavarësisht se periudha tranzitore është drejt përfundimit siç përcaktuar në Vendimin nr. 264 datë 20.12.2018 dhe në këto kushte nuk mundësohet vlerësimi i

drejtë i të ardhurave të kërkuara për aktivitetet e shpërndarjes së energjisë elektrike dhe furnizimit të shërbimit universal të këtyre dy shoqërive.

- Edhe në rast të paraqitjes së aplikimeve përkatëse të shoqërive OSSH sh.a. dhe FSHU sh.a. pranë ERE-s në këtë moment, bazuar në përcaktimet e “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s” miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, koha që mbetet në dispozicion për shqyrtimin dhe analizimin e aplikimit të paraqitur dëri në fund të këtij viti, nuk mundëson marrjen e një vendimi nga ana e ERE-s, bazuar në një proces sa më gjithëpërfshirës dhe transparent me palët e interesuara, duke patur në konsideratë impaktin që do të kishte ndryshimi i tarifës për përdoruesit e rrjetit të shpërndarjes të energjisë elektrike dhe te klientët fundor.
- Në mënyrë që shoqëria OSHEE sh.a. edhe për vitin 2020, të mundet të realizojë aktivitetet për të cilat është licencuar, konform Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, bëhet e domosdoshme që shoqëria të vijojë faturimin bazuar në çmimet e miratuara nga ERE.

Për gjithë sa më sipër shpjeguar dhe në mbështetje të nenit 19, nenit 20 germa c), nenit 83, nenit 85 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar; VKM-s nr. 244 datë 30.03.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar; nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, gërma “c” të Rregullores për “Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin nr. 96, datë 17.06.2016 të Bordit të ERE-s; “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të operatorit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike” dhe “Metodologjisë së Përcaktimit të Çmimeve për Shitjen e Energjisë Elektrike me Pakicë tek Klientët Fundorë që Furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)”, miratuar me Vendimet e Bordit të ERE nr. 182, datë 10.11.2017 dhe nr. 189, datë 23.11.2017, i propozojmë Bordit të ERE-s:

1. **Të shtyjë fuqinë juridike të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 268 datë 21.12.2018 deri në miratimin e një vendimi mbështetur në aplikimin e shoqërisë OSSH sh.a. për vitin 2020, për tarifën si më poshtë:**

Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV	1.5 Leka/Kwh
Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 20 kV	3.9 Leka/Kwh
Tarifa mesatare e shërbimit të shpërndarjes	4.79 Leka/Kwh

2. **Të shtyjë fuqinë juridike të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 268 datë 21.12.2018 deri në miratimin e një vendimi mbështetur në aplikimin e shoqërisë FSHU sh.a. për vitin 2020, për për çmimet me pakicë për klientët fundorë që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal.**

Çmimi I shitjes për Klientët në 20 kV *	11 Leke/Kwh Ne Pik 12.65 Leke/Kwh
Çmimi I shitjes për Klientët në 10/6 kV *	11 Lekë/Kwh Ne Pik 12.65 Leke/Kwh
* Miratim I përkohshëm për Klientët që nuk arrijnë të sigurojnë furnizues në treg për shkak të pamundësisë objektive të operatorëve të sistemit në përputhje me VKM nr. 449, datë 15.06.2016, furnizimi si mundësi e fundit i këtyre klientëve kryhet në të njëjtat kushte me shërbimin universal të furnizimit me çmimet si më lart	
Çmimi I shitjes për Konsumatorët e lidhur në TM dhe me matës në TU	12.4 Leke/Kwh Ne Pik 14.3 Leke/Kwh
Çmimet e shitjes me pakicë për klientët fundor	*Çmimet paraqiten ne tabelen me poshte

TARIFAT E SHËRBIMEVE TË SHITJES ME PAKICË TË ENERGISË ELEKTRIKE PËR KLIENTËT FUNDOR

Niveli I tensionit	Çmimi (Leke/kWh)	Çmimi pik (Leke/kWh)
Furra buke dhe prodhim mielli në 10/6 kV	7.1	8.17
Klientë në 0.4 kV	14	16.1
Furra buke dhe prodhim mielli në 0.4 kV	7.6	8.74
Objekte Kulti/Bashkësi Fetare	9.5	
Familjarë 0.4 kV	9.5	
Tarifa për konsumin e energjisë elektrike në ambientet e përbashkëta (ndricim shkalle, pompe ashensor)	9.5	
Tarifë fikse e shërbimit për leximin "zero" (Leke/Muaj)		200
*Çmimi I energjise reaktive eshte sa 15% e çmimit te enerajise aktive		
*Orari pik gjate te cilit do te aplikohet tarifa per energjine e konsumuar ne pik eshte		
Per periudhen I Nentor - 31 Mars nga ora 18:00 deri ne 22:00		
Per periudhen I Prill - 31 Tetor nga ora 19:00 deri ne 23:00		

- Lënien në fuqi të Vendimit të Bordit të ERE nr. 53, datë 06.04.2017 “Mbi çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi universal për kategorinë objekte kulti/bashkësi fetare”.**
- OSHEE sh.a në funksion të OSSH sh.a. dhe FSHU sh.a., përveç shlyerjes së detyrimeve korrente, të kryejë edhe pagesat ndaj KESH sh.a dhe OST sh.a për detyrimet e prapambetura në përputhje me parashikimet e VKM nr. 253, datë 24.04.2019 “Për miratimin e planit të konsolidimit financiar të sektorit publik elektroenergjetik”.**
- Rishikimin e të ardhurave të kërkuara të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal në periudhat pasardhëse për vlerësimin e të ardhurave të kërkuara për vitin 2020.**